



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT**

NJOFTIM PËR SHTYPIN

Shërbimi Informativ i Shtetit zhvillon ceremoninë e diplomimit dhe betimit të punonjësve të rinj

Tiranë, 12 nëntor 2021

SHISH-i organizoi ceremoninë e betimit dhe shpërndarjes së certifikatave për kursantët e rinj, pas përfundimit të kursit bazë të inteligjencës.

Punonjësit e rinj të Shërbimit, pas betimit, u bashkohen kolegëve të tyre në përmbushje të misionit themelor të SHISH për mbrojtjen dhe forcimin e sigurisë kombëtare, duke respektuar Kushtetutën, ligjet dhe liritë e të drejtat themelore të njeriut.

Gjatë ceremonisë, Drejtori i SHISH, z. Helidon Bendo, vlerësoi punën e sakrificat e punonjësve të komunitetit të inteligjencës dhe u bëri thirrje të rejave dhe të rinjve të aplikojnë dhe të bashkohen me SHISH-in, për t'i shërbyer Atdheut e sigurisë kombëtare.

Ndër të tjera, Drejtori i SHISH, z. Helidon Bendo, theksoi:

“Sot është një ditë e veçantë, jo vetëm për ju që mbyllni kursin bazë të formimit profesional, por edhe për mua si Drejtor i Shërbimit Informativ të Shtetit. Kur vendosëm në procedurat e Shërbimit edhe kryerjen e betimit të punonjësve të rinj, nuk synim vetëm të zhvillim një ceremoni apo të nënshkruanim një dokument. Synimi ishte që betimi të përbente një akt solemn, para Flamurit Kombëtar e atij të Shërbimit Informativ, si një angazhim madhor për t'i shërbyer me përkushtim e ndershmëri Republikës së Shqipërisë për forcimin e sigurisë kombëtare.

Jam i kënaqur që në rrugëtimin tonë të përbashkët na bashkohen kolegë të rinj. Për ju duhet të ndihen krenarë stafi akademik, kolegët që dhanë kontribut në formimin tuaj dhe, në veçanti familjet tuaja.

Gjatë kursit që ndoqët, ne i nxitim kursantët të jenë krijues, të mendojnë me origjinalitet, por në radhë të parë, të respektojnë Kushtetutën dhe ligjet e shtetit shqiptar, në funksion të sigurisë kombëtare, rajonale dhe të sigurisë së aleatëve dhe partnerëve tanë. U mësojmë të sfidojnë të panjohurën dhe të përqafojnë idetë e reja, por në radhë të parë, të jenë të përgjegjshëm, profesionalë e të respektojnë të drejtat e njeriut.

Përfundimi i trajnimit nuk është mbërritja në fundin e rrugës; është më tepër fillimi i një udhëtimi të ri, edhe më emocionues dhe të paparashikueshëm. Megjithatë pasiguria nga

e panjohura nuk duhet parë si pengesë, por si mundësi për të qenë më të motivuar në të menduar dhe në të vepruar.

Dëshiroj t'ju transmetoj një mesazh në këtë ditë solemne: Punonjësi i SHISH-it nuk është supernjeri, por është pjesë e shoqërisë, me hallet e shqetësimet e përditshme, me vuajtjet e gëzimet e jetës. Ndaj për të qenë një punonjës i mirë duhet të jeni mbi të gjitha qytetar i mirë. Profesionit e karriera kanë ciklet e tyre, kanë ulje-ngritjet e tyre, që ndonjëherë na duken të padrejta, por në fund diçka është e sigurtë: “Qytetari i mirë, besnik i Kushtetutës, ligjit e moralit shoqëror, bëhet një inspektor shumë i mirë dhe i shpërblyer”.

Puna në terren është e vështirë, kërkon kurajë, përshtatshmëri dhe korrektesë. Ato që keni mësuar në teori, tani do t'i zbatoni në praktikë, por këtu nuk ka vend për frikë e stepje. Nëse zbatoni ligjin, rregullat e sigurisë operacionale, ruani sekretin, ruani qëllimin dhe misionin e Shërbimit, do të jeni të suksesshëm.

Duke ju uruar suksese në këtë kapitull të ri të jetës suaj, shpreh bindjen që do t'i vini në praktikë mësimet e përfituara dhe do të vazhdoni ndërveprimin pozitiv me kolegët. Kjo organizatë nuk është e Drejtorit apo e Drejtorëve. Kjo është organizata juaj dhe nga nesër do të jetë edhe shtëpia juaj”.

KABINETI I DREJTORIT TË SHISH